



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORT RREGULLATIV
Përcaktimi i Tarifave për Ngrrohtoren e Qytetit GJAKOVA SH.A.
Sezoni i Ngrrohjes 2022-2023

Prishtinë, dhjetor 2022



1. Hyrje – Struktura Tarifore

Struktura tarifore për energjinë termike është përcaktuar në përputhje me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike të nxjerrë nga ZRRE (Kapitulli IV: Tarifave të energjisë termike – nenet 15 dhe 16). Struktura e tarifave të energjisë termike përmban 2 lloje të tarifave: Tarifave për 'konsumatorët me matje' dhe tarifave për 'konsumatorët pa matje', varësisht nga Infrastruktura e matësve (njehsorëve) të energjisë termike.

1.1 Tarifave për 'konsumatorët me matje'

Tarifave për 'konsumatorët me matje' janë të bazuara në konsumin e matur dhe të regjistruar të energjisë termike. 'Tarifave me matje' përbëhen nga:

- Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa mujore e kapacitetit bazuar në kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes [€/kW për muaj]; dhe
- Komponenti variabil i tarifës: ngarkesa mujore e energjisë bazuar në furnizimin e matur me ngrohje [€/MWh apo €cent/kWh];

1.2 Tarifave për 'konsumatorët pa-matje'

Tarifave për 'konsumatorët pa-matje' bazohen në sipërfaqen e hapësirës së ngrohur të konsumatorëve. Duke marrë parasysh se vlerat e parallogaritura për kapacitetin dhe konsumin specifik të energjisë termike për metër katrorë janë të ndryshme për Konsumatorët Shtëpiak dhe ata Komercial e Institucional, për këtë, me qëllim që tarifave të reflektojnë strukturën specifike të konsumit për secilën kategori, 'tarifave pa-matje' ndahen në dy nën-grupe:

- Tarifave për konsumatorët shtëpiak; dhe
- Tarifave për konsumatorët komercial e Institucional.

Më tutje, 'tarifave pa-matje' kategorizohen në dy komponentë:

- Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa mujore e kapacitetit bazuar në një vlerë të përafërt për kapacitet të ngrohjes për metër katror të hapësirës për ngrohje [€/m² për muaj]; dhe
- Komponenti variabil i tarifës: pagesa mujore e energjisë bazuar në një vlerë të përafërt për konsum të ngrohjes për metër katror të sipërfaqes ngrohëse [€/m² për muaj].

2. Alokimi i të Hyrave të Lejuara dhe Përcaktuesit e Faturimit

Duke ju referuar Shtojcës 6: "Detajet për Llogaritjen e Tarifave" të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, si dhe për të reflektuar strukturën tarifore, për llogaritjen e tarifave të energjisë termike duhet të përcaktohet alokimi i të Hyrave të Lejuara dhe Përcaktuesit e Faturimit.

Lidhur alokimin e të hyrave të lejuara konform strukturës tarifore, duhet theksuar se NQ Gjakova për këtë sezonë nuk ka planifikuar fare faturimin me matje d.m.th. nuk ka paraqitur të dhëna për numrin e konsumatorëve dhe sipërfaqet ngrohëse përkatëse që potencialisht do të faturoheshin me matje në sezonin 2022/2023. Për këtë arsye ZRRE nuk ka qenë në gjendje të bëjë alokimin e të hyrave të lejuara për konsumatorët me matje dhe të llogarisë përcaktuesit e faturimit me matje; rrjedhimisht në pamundësi të përcaktimit të këtyre dy komponentëve për llogaritjen e tarifave me matje, ZRRE ka përcaktuar të njëjtat tarifa për konsumatorët me matje si në sezonin e kaluar 2021/2022.

Nga sa u tha më lartë, në vijim është dhënë alokimi i të hyrave të lejuara dhe përcaktuesit e faturimit vetëm për konsumatorët pa-matje.



2.1 Alokimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara (HML)

Alokimi i të Hyrave të lejuara bëhet konform strukturës tarifore, të përshkruar në pikën '1' më lartë, me pikë fillestare të Hyrat e Lejuara, siç janë përcaktuar në Raportin për të Hyrat e Lejuara për NQ Gjakova për sezonin e ngrohjes 2022/23, në vlerë prej **839,755 €**. Kriter themelorë për alokimin është konsumi i përlogaritur i energjisë termike për secilën kategori/komponentë tarifore. Bazuar në këtë kriter dhe kategoritë / komponentët e strukturës tarifore, janë përcaktuar koeficientët e alokimit dhe alokimi respektiv i të Hyrave të Lejuara; detajet në vijim:

- Alokimi i HML në komponentën Fikse dhe Variabile:

Tarifat pa-matje:

- | | |
|---|--|
| i) Pjesa fikse e të Hyrave të Lejuara: | HML_F = 83,976 €; dhe |
| ii) Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara: | HML_V = 755,779 € |
| | |
| i) Pjesa fikse e të Hyrave të Lejuara: | HML_F = 83,976 €; |
| e cila më tutje ndahet në: | |
| ▪ kategorinë shtëpiak: | HML _{F(Sh)}} = 33,969 € dhe |
| ▪ kategorinë komercial e institucional: | HML _{F(K&I)}} = 50,007 € |
| | |
| ii) Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara: | HML_V = 755,779€ |
| e cila më tutje ndahet në: | |
| ▪ kategorinë shtëpiak: | HML _{V(Sh)}} = 305,721 € dhe |
| ▪ kategorinë komercial e institucional: | HML _{V(K&I)}} = 450,058 € |

2.2 Përcaktuesit e Faturimit

Njëjtë si alokimi i të Hyrave të Lejuara, edhe përcaktuesit e faturimit reflektojnë dhe janë në pajtim me strukturën tarifore; detajet në vijim:

Për tarifat 'pa-matje':

- | | |
|--|--|
| i) Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve shtëpiak: | S_(Sh) = 62,750 m²; dhe |
| ii) Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve komercial e Institucional: | S_{(K&I)}} = 64,620 m² |

3. Nivelet e Tarifave të Energjisë Termike

Në pajtim me strukturën tarifore, si dhe bazuar në alokimin e të Hyrave të Lejuara dhe përcaktuesit e faturimit, llogariten nivelet e tarifave për secilën kategori / komponentë tarifore, siç paraqiten në tabelën vijuese:

Siç u theksua në pikën '2' më lartë, për shkak të mos-planifikimit nga NQ Gjakova të faturimit pa matje, ZRRE nuk ka mundur të llogarisë përcaktuesit e faturimit dhe alokimin e të hyrave të lejuara, të domosdoshme për llogaritjen e tarifave me matje. Për këtë ZRRE vendos që në këtë sezonë të përcaktojë tarifën e njëjta si në sezonin e kaluar (tabela 1).



Tabela 1: Struktura dhe nivelet e tarifave të energjisë termike me matje për NQ Gjakova – sezoni 2022/'23

TARIFAT E ENERGISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezoni 2022/2023		
A: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE ME MATJE		
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.85
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variabile)	[€/MWh]	54.65

Në tabelën 2 më poshtë paraqitet struktura tarifore dhe nivelet e tarifave të energjisë termike pa-matje të llogaritura bazuar në alokimin përkatës të të hyrave të lejuara dhe përcaktuesve të faturimit.

Tabela 2: Struktura dhe nivelet e tarifave të energjisë termike pa-matje për NQ Gjakova për sezonin 2022/23:

Llogaritja e Tarifave të Energjisë Termike -sezoni 2022-2023						
B. Tarifat e Energjisë Termike Pa Matje						
Simboli/Poz.	Përshkrimi	Formula	Njësia	Vlera		
				Gr. Kons. Shtëpijak	Gr. Kons. Kom. e Inst.	Total / Mesatare
$HML_{(pa\ matje)}$	Të Hyrat Maksimale të Lejuara për tarifën pa matje	$HML_{(pa\ matje)} = k_{al(pa\ matje)} * HML$	Euro	339,690	500,065	839,755
$HML_{f(pa\ matje)}$	Pjesa fikse e MAR për tarifën pa matje	$HML_{f(pa\ matje)} = k_{s(qt12)} * HML_{(pa\ matje)}$	Euro	33,969	50,007	83,976
$HML_{v(pa\ matje)}$	Pjesa variabile e MAR për tarifën pa matje	$HML_{v(pa\ matje)} = k_{al(vark)} * HML_{(pa\ matje)}$	Euro	305,721	450,058	755,779
$S_{(pa\ matje)}$	Sipërfaqja ngrohëse e Kons. pa matje		m ²	62,750	64,620	127,370
T_{yHC}	Tarifa Sezonalë për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{yHC} = HML_{f(pa\ matje)} / S_{(pa\ matje)}$	€/m ² për sezonë	0.54	0.77	0.66
T_{yHD}	Tarifa Sezonalë për Sasinë e furnizuar të En. Term. (Komp. Variab.)	$T_{yHD} = HML_{v(pa\ matje)} / S_{(pa\ matje)}$	€/m ² për sezonë	4.87	6.96	5.93
T_{mHC}	Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{mHC} = T_{yHC} / 6$	€/m ² për muaj	0.09	0.13	0.11
T_{mHD}	Tarifa Mujore për Sasinë e furnizuar të En. Term. (Komp. Variab.)	$T_{mHD} = T_{yHD} / 6$	€/m ² për muaj	0.81	1.16	0.99
T_{total}	Totali i tarifës mujore pa matje	$T_{total} = T_{mHC} + T_{mHD}$	€/m ² për muaj	0.90	1.29	1.10